

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6888
E shtunë, 6 maj 2023
Çmimi 0.40 €

Përrurohet shtatorja e heroit të kombit Fahri Fazliu

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

A ËSHTË NË KUNDËRSHTIM ME MARRËVESHJET SHPËRBËRJA E EKIPIT MENAXHUES?

FAQE 4-5



Bashkimi Evropian (BE) ka theksuar se vendimi i Qeverisë së Kosovës për shpërbërjen e Ekipit Menaxhues për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është në

kundërshtim me marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka pohuar se Ekipi Menaxhues duhet të jetë funksional derisa të miratohet statuti për formimin e

Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Ndërkaq Qeveria e Kosovës në reagimin e saj ka bërë me dije se vendimi për ekipin menaxhues nuk është në kundërshtim me marrëveshjen

SPECIALJA REFUZON 20 PERSONA PËR TË MARRË PJESË SI VIKTIMA NË RASTIN E LIDERËVE TË UÇK-së

FAQE 3



MEHAJ NË ITALI INTERESOHET PËR MBROJTJEN, EDUKIMIN DHE TRAJNIMIN E USHTARAKËVE TË FSK-së

FAQE 5

OPINION

A DO TË QUHET UNIVERSITETI 'HASAN PRISHTINA' NË TË ARDHMEN 'MIRËDITA - DOBARDAN'?

F. 6



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

AKTUALE



OKB-ja: ÇMIMET E USHQIMEVE RRITEN PËR HERË TË PARË PAS NJË VITI


F. 7

AKTAKUZË NDAJ TRE PERSONAVE PËR VRASJEN E TREFISHTË NË GLLOGJAN

F. 7



EKONOMI



KRIZA BANKARE NUK KA MBARUAR NË SHBA. SA KEQ MUND TË SHKOJNË GJËRAT?

F. 8

ZYRTARË TË BQK-SË DHE TË AKK-së TAKOHEN PËR ÇËSHTJE TË KONKURENCËS NË SEKTORIN FINANCIAR

F. 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja: Çmimet e ushqimeve rriten për herë të parë pas një viti

ROME, 5 MAJ - Agjencia për Ushqim e Kombeve të Bashkuara tha se, sipas të dhënave në prill, çmimet e ushqimeve u rritën për herë të parë brenda një viti. Por, megjithatë, çmimet janë 20 për qind më të ulëta krahasuar me muajin mars të vitit 2022, kur u shënuar rekord i rritjes së çmimeve pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës.

Indeksi i çmimeve të Organizatës për Ushqim dhe Agrikulturë (FAO) muajin e kaluar ishte mesatarisht 127.2 pikë krahasuar me 126.5 pikë në mars. Kjo agjenci tha se rritja e çmimeve në prill është për shkak të rritjes së çmimeve të sheqerit, mishit dhe orizit, që kompensuan rënien e

çmimeve të drithërave, bulmetit dhe vajit ushqimor. "Teksa ekonomitë rimëkëmben nga ngadalësimi i rritjes ekonomike, kërkesat do të rriten, duke rritur presionin edhe ndaj çmimeve të ushqimeve", the ekonomisti në FAO, Maximo Teroro.

Rritja e çmimit të sheqerit, që në mars arriti në 17.6 për qind, ishte rritja më e madhe e regjistruar që nga viti 2011. FAO tha se rritja e çmimit të këtij produkti lidhet me furnizimet e pakta për shkak të rënies së prodhimit në Indi dhe Kinë.

Ndërkaq, sipas indeksit, çmimet për mish u rritën për 1.3 për qind nga muaji në muaj, ndërkaq çmimi i vajit ushqimor ra për 1.7 për qind. Por, rritje të madhe



kanë shënuar çmimet e orizit. "Rritja e çmimeve të orizit është mjaft shqetësuese dhe është thelbësore që nisma e Detit të Zi të ripërtërihet, për të shmangur edhe një rritje tjetër të çmimeve të grurit dhe elbit", tha Torero. Ai iu referua marrëveshjes që lejon eksportin e drithërave ukrainase përmes porteve të Detit të Zi, që Rusia bllokoi pas pushtimit të Ukrainës.

Rusia dhe Ukraina janë dy prej prodhuesve më të mëdha në botë të drithërave.

Ndërkaq, në një raport të ndarë për furnizimet me drithëra, FAO tha se parashikon që prodhimi botëror i grurit më 2023 të jetë 785 milionë tonë, apo pak më pak sesa më 2022.

Numër i madh i fëmijëve të vrarë në Sudan

KARTUM, 5 MAJ - Kombet e Bashkuara paralajmëruan të premten se një numër i madh fëmijësh po vdesin në konfliktin e Sudanit, duke vënë në dukje raportet që tregojnë se shtatë fëmijë vriten ose plagosen çdo orë. "Siç u frikësuan dhe siç paralajmërohej, situata në Sudan është bërë fatale për një numër të madh fëmijësh", u tha gazetarëve në Gjenevë, James Elder, zëdhënës i agjencisë së OKB-së për fëmijë, UNICEF.

Ai tha se agjencia ka marrë raporte nga një partner i besuar - ende i paverifikuar në mënyrë të pavarur nga OKB-ja - se 190 fëmijë u vranë dhe 1 700 u plagosën vetëm në 11 ditët e para të konfliktit që filloi më 15 prill.

Elder vuri në dukje se ata numra janë mbledhur nga institucionet shëndetësore në Kartum dhe rajonin e Darfurit. Kjo do të thotë se mbulon



vetëm fëmijët që arritën në institucionet e kujdesit shëndetësor në ato zona, tha ai, duke paralajmëruar se "realiteti ka të ngjarë të jetë shumë më i keq".

Qindra njerëz janë vrarë dhe

ish- zëvendësit të tij, Mohamed Hamdan Daglo.

Palët kanë rënë dakord për një varg armëpushimesh të shkurtra, por asnjëra nuk është respektuar plotësisht dhe të shtënat me armë vazhduan ta tronditin Kartumin për ditën e 21 me radhë.

Agjencia e OKB-së për refugjatët dënoi gjithashtu situatën e rëndë në Sudan, duke u kërkuar të gjitha vendeve që të përmbahen nga kthimi i shtetasve sudanezë në vend. "UNHCR u kërkon të gjitha vendeve që t'i japin civilëve që ikin nga Sudani qasje jodiskriminuese në territoret e tyre", u tha gazetarëve Elizabeth Tan, shefja e mbrojtjes ndërkombëtare brenda kësaj agjencie. "Kjo vlen për shtetasit sudanezë, shtetasit e huaj, duke përfshirë refugjatët që po strehoheshin nga Sudani,

personat pa shtetësi dhe ata që nuk kanë pasaporta ose dokumente të tjera identiteti", tha ajo.

UNHCR ka thënë se po përgatitet për një largim të 860 000 njerëzve nga Sudani në vendet fqinje, me më shumë se 113 000 njerëz që janë larguar tashmë nga vendi.

Qindra mijëra të tjerë janë zhvendosur brenda Sudanit. "Ne u jemi mirënjohës të gjitha vendeve fqinje që i kanë lejuar ata të kërkojnë siguri", tha Tan. Duke treguar për paqëndrueshmërinë aktuale në Sudan, ajo tha se agjencia u bëri thirrje vendeve që "ta pezullojnë nxjerrjen e vendimeve negative për kërkesat për azil të paraqitura nga shtetas sudanezë ose persona pa shtetësi që banonin zakonisht atje". Ajo theksoi se vendimet negative të azilit të dhëna më parë mund të kenë nevojë të rishqyrtohen.

Një i vdekur nga tërmeti i fuqishëm në Japoni

TOKIO, 5 MAJ - Një tërmet i fuqishëm goditi Japoninë qendrore të premten, duke lënë të paktën një person të vdekur dhe 21 të lënduar. Tërmeti me magnitudë 6.5 shkallë goditi rajonin qendror Ishikawa në mesditë, në një thellësi prej 12 kilometrash, sipas Agjencisë Meteorologjike të Japonisë.

Zyrtarët e motit paralajmëruan banorët për dridhje të tjera të mundshme dhe rrëshqitje të dheut në ditët në vijim, por thanë se nuk kishte rrezik për cunami. "Ishte një dridhje e madhe dhe e gjatë që zgjati rreth dy minuta. U ndjeva i frikësuar

sepse lëkundjet vazhduan", i tha transmetuesit publik një zyrtar i qeverisë lokale në qytetin e Suzu, i cili nuk pranoi ta jepte emrin.

Zëdhënësi i qeverisë, Hirokazu Matsuno, u tha gazetarëve në kryeqytetin Tokio, se një person u raportua i vdekur dhe se kishte "raportime të shumta për ndërtesa të shembura". "Viktima ra nga një shkallë", tha për AFP-në një zyrtar i menaxhimit të krizës, duke shtuar se 21 persona të tjerë ishin plagosur. Agjencia lokale e menaxhimit të zjarrit dhe fatkeqësive tha se të paktën tri ndërtesa ishin

shkatërruar me dy persona të bllokuar brenda.

Njëri ishte nxjerrë nga rrënojat dhe ishte dërguar në spital dhe ekipet e shpëtimit po kërkonin tjetrin.

Shërbimi Gjeologjik i ShBA-së e vendosi magnitudën në 6.2 dhe tha se tërmeti goditi në bregdet, por Agjencia Meteorologjike e Japonisë tha se epiqendra e tërmetit ishte në tokë.

Ministri japonez i parandalimit të fatkeqësive, Koichi Tani, tha se kishte raporte për rrëshqitje të shumta dheu dhe disa vendas ishin strehuar në strehimoret e evakuimit.



Specialja refuzon 20 persona për të marrë pjesë si viktimë në rastin e liderëve të UÇK-së

HAGË, 5 MAJ - Angela Griep, shefe e Informimit dhe Komunikimit Publik në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK), përmes platformës online "zoom", në konferencë për medie, ka bërë me dije se Paneli i Gjykatës së Apelit ka refuzuar ankesat e 20 personave për të marrë pjesë si viktimë në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. "Të mërkurën, më 26 prill 2023, paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelet e 20 personave për të marrë pjesë në proces gjyqësor si viktimë të cilët kishin apeluar vendimin e trupit gjyqësor, ku u refuzua kërkesa e tyre për pjesëmarrje në çështjen gjyqësore Thaçi dhe të tjerët", ka thënë Griep. Sipas saj, paneli ka vendosur se personat mund të dorëzojnë sërish kërkesë në qoftë se i paraqesin informacione të reja trupit gjyqësor, raporton "Betimi për Drejtësi". Ajo ka theksuar se apelet janë dorëzuar nga dy mbrojtës që përfaqësojnë 20

personat të cilëve iu refuzuan kërkesat.

Më tutje, ajo ka thënë se në të njëjtën çështje gjyqësore më 28 prill trupi gjyqësor ka rrëzuar kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS-së) për miratimin e një procedure për rastet kur mund të dalë aspekti i vetinkriminimit nga vetë dëshmitari në bazë të rregullës 151. "Trupi gjyqësor është i mendimit se rregulla 43 dhe 151 të marra së bashku me paragrafin 97v të urdhrin për zhvillimin e gjyqësorit e rregullojnë siç duhet aspektin e vetinkriminimit të mundshëm nga dëshmitarët në këtë fazë të procesit gjyqësor", ka thënë Griep.

Më tutje, ajo ka deklaruar se në bazë të rregullit 151, një dëshmitar mund të kundërshtojë të japë dëshmi që mund ta inkriminojnë, megjithatë trupi gjyqësor mund të detyrojë një dëshmitar të dëshmojë, për shembull nëse dëshmitari do të japë dëshmi unike për çështjen gjyqësore. "Në një rast të tillë



trupi gjyqësor duhet t'i japë garanci dëshmitarit se gjykata nuk do të veprojë lidhur me vetinkriminimin para dhënies së dëshmisë", ka thënë Griep. Në këtë konferencë ajo ka

njoftuar se më 1 maj 2023 dhe në vijim të vendimit nga trupi gjyqësor, administratorja ka përfunduar emërimin e David Young si mbrojtës të Rexhep Selimit dhe ka caktuar Geoffrey

Roberts si mbrojtës zëvendësues. Po ashtu, ajo ka njoftuar se seancat në rastin e liderëve të UÇK-së do të rinisin më 10 maj me fillim nga ora 09:00.

Aktakuzë ndaj tre personave për vrasjen e trefishtë në Glllogjan



PRISHTINË, 5 MAJ - Prokuroria e Pejës ka ngritur aktakuzë ndaj tre personave për vrasjen e tre personave më 26 nëntor 2021 në fshatin

Glllogjan të Deçanit. Në një konferencë për medie më 5 maj, prokurorja e rastit, Sahide Gashi, njoftoi se, pas hetimeve prej një viti e

gjysmë, kanë ngritur aktakuzë për vrasje të rëndë kundër Kastriot Mehmetajt dhe Kreshnik Mehmetajt. Aktakuzë u ngrit edhe ndaj

Halil Mehmetaj për shtytje në këtë vepër penale. Prokurorja Gashi dha edhe hollësi të tjera nga hetimi i vrasjeve dhe foli edhe për

motivin e mundshëm. "Nuk ka indikacione për një sulm terrorist. Kemi të bëjmë me një ekzekutues, me shumë gjasë të maskuar. Target i sulmit ishte shoferi i autobusit", tha ajo dhe shtoi se sulmi ishte mirë i planifikuar.

Çfarë ndodhi në Glllogjan?

Vrasja e tre personave kishte ndodhur pas një sulmi të armatosur ndaj një autobusi që po bartte edhe nxënës në Glllogjan.

Të vrarë mbetën dy nxënës dhe shoferi i autobusit.

Mbrëmjen e 26 nëntorit të vitit 2021 në Glllogjan, rreth orës 19:00, autobusi që vinte nga Gjakova u sulmua. Të vrarë mbetën ngasësi i autobusit dhe dy nxënës që ndodheshin brenda. Menjëherë pas ngjarjes, policia njoftoi se nuk ka arsye për të besuar se sulmi ka motive terroriste. Autoritetet atëbotë ofruan shpërblim prej 20 000.00 eurosh për këdo që jepte informata që do të çonin në arrestimin e autorëve të këtij sulmi.

Policia zhvillon fushatë vetëdijesimi për sigurinë në trafik

MITROVICË, 5 MAJ - Me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë në trafikun rrugor, policia në rajonin e Mitrovicës së Jugut dhe në

rajonin e Veriut përmes aktiviteteve (fushatës) javore po synon të rritë ndërgjegjësimin e shoferëve për kujdes gjatë

drejtimit të mjetit. Nën moton "Shofer, kujdes" në të dy rajonet e Mitrovicës, pjesëmarrësve në trafik, veçanërisht shoferëve, u

janë shpërndarë të premtën fletushka me mesazhe informuese dhe vetëdijesimi për kujdes dhe respektim të shpejtësisë.





A është në kundërshtim me marrëveshjet shpërbërja e Ekipit Menaxhues?

Bashkimi Evropian (BE) ka theksuar se vendimi i Qeverisë së Kosovës për shpërbërjen e Ekipit Menaxhues për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është në kundërshtim me marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka pohuar se Ekipi Menaxhues duhet të jetë funksional derisa të miratohet statuti për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Ndërkaq Qeveria e Kosovës në reagimin e saj ka bërë me dije se vendimi për ekipin menaxhues nuk është në kundërshtim me marrëveshjen

Prishtinë, 5 maj - Kosova dhe Serbia sërish i interpretojnë ndryshe marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Kësaj radhe ka pasur një "konfuzion" lidhur me mandatin e Ekipit Menaxhues për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Më 3 maj autoritetet e Kosovës e liruan nga detyra Ekipin Menaxhues, me arsyetimin se një ditë më parë në Bruksel e kishin paraqitur statutin dhe se i kishte përfunduar mandati. Për këtë reagueshan ashpër autoritetet nga Serbia, duke theksuar se mandati i Ekipit Menaxhues nuk përfundon me prezantimin e projekt-statutit të Asociacionit, por se ai ka një rol të rëndësishëm në vetë procesin

e formimit të tij.

Pastaj erdhi interpretimi i Bashkimit Evropian, si lehtësues i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Nga BE-ja thanë se vendimi i Qeverisë së Kosovës për shpërbërjen e Ekipit Menaxhues është në kundërshtim me marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, tha më 4 maj se Ekipi Menaxhues duhet të jetë funksional derisa të miratohet statuti për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Ekipi menaxhues propozoi dhe paraqiti draftin [statutin] e parë, që do të thotë se ka filluar procesin dhe jo se procesi ka përfunduar. Prandaj, vendimi

për shpërbërjen e Ekipit Menaxhues bie ndesh me tekstin dhe frymën e marrëveshjes", tha Stano.

Por, lidhur me deklaratat për shpërbërjen e Ekipit Menaxhues të zëdhënësit të BE-së, Peter Stano, ka reagueshan Qeveria e Kosovës. Në reagim thuhet se vendimi i Qeverisë së Kosovës për ekipin menaxhues nuk është në kundërshtim me marrëveshjen. "Nga deklarata e zëdhënësit të BE-së vihet re se ka minimum të njohurisë për atë që po zhvillohet në procesin e dialogut, por maksimum gatishmërie për nxjerrjen e deklaratave kundër Kosovës. Gatishmërinë e njëjtë duhet ta ketë kur ka shkelje aktuale të marrëveshjes si, për shembull, vota kundër e Serbisë në

Këshillin e Evropës, për të cilën po gjendet në vështirësi kur përgjigjet. Apo edhe për shkeljet e tjera që Serbia po ia bën marrëveshjes", thuhet në reagim.

Sipas Qeverisë së Kosovës, "Ekipi Menaxhues e ka pasur vetëm një mision apo detyrë - përgatitja dhe prezantimi i draftit të statutit. Pas këtij prezantimi nuk ka më asnjë rol sepse diskutimi tashmë është politik".

Kur u ra dakord për krijimin e Ekipit Menaxhues?

Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe është arritur në vitin 2013. Marrëveshja parashikonte që Asociacioni të formohej në bazë të statutit, të kishte kryetar, nënkryetar, kuvend dhe këshill dhe se shpërbërja e tij mund të bëhej vetëm me vendim të komunave anëtare.

Ky bashkim duhet të përbëhet nga dhjetë komuna me shumicë serbe në Kosovë - gjashtë në jug të Ibrit: Graçanica, Shtërpca, Novobërda, Kllokoti, Ranillugu

dhe Parteshi - dhe katër në veri, Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku.

Në mënyrë që të gjitha këto komuna ta formojnë Asociacionin, fillimisht është dashur të mbahen zgjedhjet lokale sipas ligjeve të Prishtinës zyrtare në veri të Kosovës, në mënyrë që të formohen katër komuna. Kjo ndodhi në nëntor të vitit 2013.

Mirëpo zgjedhjeve u ka paraprirë Plani i Zbatimit të marrëveshjes nga viti 2013, në të cilin për herë të parë përmendet Ekipi Menaxhues për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Kështu parashihej që të dyja palët të formojnë një Ekip Menaxhues për krijimin e Asociacionit deri në fund të majit të vitit 2013, me qëllim hartimin e statutit, por edhe për t'i trajtuar "të gjitha çështjet që janë relevante për krijimin e Asociacionit".

Gjithashtu, ishte planifikuar që Ekipi Menaxhues të përbëhet nga përfaqësues të katër komunave nga veriu, të cilët do të themeloheshin pas konfirmimit nga autoriteti kompetent i Kosovës.

Mehaj në Itali, vizita fokusohet në fushën e mbrojtjes, edukimit dhe trajnimit të ushtarakëve të FSK-së

PRISHTINË, 5 MAJ - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka qëndruar për vizitë zyrtare në Itali. Ai është prituar me nderime ushtarake nga ministri i Mbrojtjes i Italisë, Guido Crosetto.

Ministrin Mehaj e shoqëronin edhe zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, ambasadorja e Kosovës në Itali, Lendita Haxhitasimi dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë takim ministri Mehaj dhe homologu i tij italian diskutuan rreth bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, edukimit dhe trajnimit të ushtarakëve të FSK-së në fusha specialistike, forca speciale, aviacion e mjekësi.

Gjithashtu, ministri Mehaj shprehu edhe njëherë gatishmërinë për ofrimin e trajnimeve në fushën e kërkim-shpëtimit urban, çminimit dhe



eliminimit të materieve të rrezikshme. Përveç të tjerash, në këtë takim u bisedua dhe për

situatën aktuale gjeopolitike, luftën në Ukrainë dhe rëndësinë e unitetit për

mbështetjen e ukrainasve në luftën kundër agresorit rus. Në këtë aspekt ministri Mehaj

bëri me dije se Kosova mban qëndrim të qartë kundër politikave ruse dhe në vazhdimësi, si pjesë e Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, ai theksoi se vendi ynë është duke ofruar gjithçka që është e mundur brenda kapaciteteve, duke përfshirë pranimin e refugjatëve si dhe integrimin e gazetarëve ukrainas në Kosovë dhe ofrimin e trajnimeve me instruktorë specialistë të Qendrës Ndërkombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

Në fund të këtij takimi Mehaj falënderoi ministrin Crosetto për mbështetjen e deritanishme ofruar nga shteti italian, duke u zotuar për vazhdim të thellimit të këtij bashkëpunimi, që është në funksion të ruajtjes së paqes dhe stabilitetit të gjithëmbarshtëm.

Bislimi pret në takim deputetin e Bundestagut gjerman, temë diskutimi energjia



PRISHTINË, 5 MAJ - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka prituar të premten në takim deputetin e Bundestagut gjerman nga radhët e të Gjellbërve, Boris Mijatovic.

Zëvendëskryeministri Bislimi e vlerësoi lart rolin e Gjermanisë si partnere dhe aleate kyçe të Kosovës, duke theksuar me rëndësi të veçantë mbështetjen e tyre të madhe e aktive në proceset e integritimit evropian. "Përkrahja edhe në zhvillim ekonomik e sektorë të rëndësishëm si energjia, përmes projekteve të ndryshme të mbështetjes e bashkëpunimit, veçse e komplementon kuadrin e punës së përbashkët në shërbim të vizionit tonë për zhvillim dhe mirëqenie të të

gjithë qytetarëve në çdo cep të vendit", ka thënë Bislimi.

Deputeti Mijatovic vuri në dukje progresin e Kosovës të reflektuar në indeksin e këtij viti të Reporterëve pa Kufij (RSF), ku Kosova u rrit për 22 vende në dy vjetet e fundit, si dëshmi të vlerave demokratike dhe evropiane të cilat i përfaqëson e jetëson Kosova. Po ashtu, edhe angazhimin e qeverisë në luftimin e korrupsionit dhe punën e bërë në këtë drejtim. Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi deputetin Mijatovic për ndihmën e ofruar sa i përket agjendës së Kosovës në lidhje me rrugëtimin e tranzicionit drejt energjisë së gjelbër e të ripërtëritshme, për të cilën qeveria mbetet e përkushtuar dhe ka miratuar Strategjinë për Energji 2022-2031.

Kur duhet të shpërndahe Ekipi Menaxhues?

Sipas Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, dy palët kanë arritur një marrëveshje tjetër në vitin 2013 lidhur me mandatin e Ekipit Menaxhues për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Radio Evropa e Lirë" nuk ka mundur ta gjejë këtë dokument në mesin e dokumenteve të publikuara të Qeverisë së Kosovës apo BE-së.

Sipas dokumentit që gjendet në uebfaqen e Zyrës për Kosovën, Ekipi Menaxhues është dashur të shpërbëhet pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në veri dhe formimit të Asociacionit të

Komunave me Shumicë Serbe. Megjithatë, veprimet për krijimin e Asociacionit nuk u realizuan kurrë në terren dhe në vitin 2015 palët ranë dakord për parimet mbi bazën e të cilave duhej të formohej. Më pas, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se disa nga parimet nuk janë në përputhje me 23 nenet e Kushtetutës, të cilat autoritetet në Prishtinë i përdorën si shpjegim për refuzimin e krijimit të Asociacionit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të Ekipit Menaxhues

Ekipi Menaxhues, përsëri në bazë të dokumentit të disponueshëm në uebfaqen e

Zyrës për Kosovën të Qeverisë së Serbisë, është dashur t'i ndërmarrë të gjitha "masat e nevojshme praktike për themelimin e Asociacionit". Masat praktike përfshijnë: përgatitjen e infrastrukturës për ambientet zyrtare të Asociacionit; identifikimin e burimeve të nevojshme njerëzore; duke ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative.

Gjithashtu, Ekipi Menaxhues duhej ta kishte hartuar statutin e formimit të Asociacionit, i cili do të përcaktonte në mënyrë specifike themelimin dhe qëllimin e tij, strukturën organizative, proceset vendimmarrëse dhe kompetencat e tij.

Statuti është hartuar në vitin 2018,

por është paraqitur si pjesë e dialogut politik të nivelit të lartë më 2 maj 2023. Kosova e refuzoi këtë statut me shpjegimin se Beogradi zyrtar në Kosovë dëshiron të krijojë Republikën Sërpska, një nga entitetet në Bosnjë-Hercegovinë.

Ekipi Menaxhues dhe autoritetet e Kosovës

Sipas Marrëveshjes së Brukselit, Ekipi Menaxhues duhej të luante një "rol përfaqësues ndaj autoriteteve qendrore në Prishtinë". "Autoritetet qendrore do të konsultohen me Ekipin Menaxhues për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale në

përputhje me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale dhe ligjet e Kosovës", thuhet në të.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal në Qeverinë e Kosovës, Elbert Krasniqi, në fund të prillit ka thënë e se ka ftuar në takim Ekipin Menaxhues, por askush nuk është përgjigjur. Ai ka nënvizuar se vendimi i vitit 2020 parasheh që Ekipi Menaxhues të raportojë për aktivitetet e tij te ministri i Vetëqeverisjes Lokale në Qeverinë e Kosovës.

Ky ekip përbëhej nga katër anëtarë nga komuniteti serb: Danijela Vujićiq, Jelena Bolović, Igor Kalamar dhe Dejan Radojković. Aktualisht nuk është e qartë nëse do të formohet një ekip i ri menaxhues.

A do të quhet Universiteti “Hasan Prishtina” në të ardhmen “Mirëdita - Dobardan”?



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Patriotët jugosllavë dhe serbë kundër Hasan Prishtinës: Edhe në kohën kur Universiteti i Prishtinës u emërua me emrin e Hasan Prishtinës, ideologut dhe luftëtarit shqiptar për çlirim dhe bashkim kombëtar, deri kur u vra nga vrasës të paguar për qëllime politike në Selanik të Greqisë, kishte të tillë, kryesisht mbetjet jugosllave dhe serbe që flisnin shqip që, në heshtje e kundërshtonin këtë emërtim. Emri dhe vepra e Hasan Prishtinës ishin të pakapërcyeshme edhe për rrogëtarët besnikë që i shërbyen Jugosllavisë dhe Serbisë, atëherë e sidomos tani, shkëlqyeshëm të sistemuar në institucionet kosovare, prandaj edhe kundërshtimi nuk ishte shumë i zëshëm. Hasan Prishtina ishte i vetmi politikan shqiptar që luftoi për liri dhe bashkim kombëtar edhe politikisht si deputet i Kuvendit turk, por edhe ushtarakisht si udhëheqës i kryengritësve shqiptarë. Ishte i pakompromis kur ishin në pyetje çështja kombëtare dhe atdheu, deri në kohën kur e vranë pabesisht në Selanik, Balto Stambolla, me bashkëpunëtorë! Në historinë e re dhe para kësaj, nuk ka politikan më të zotit, më të përgatitur dhe më të vendosur për çdo sakrificë se që ishte Hasan Prishtina. Hasan Prishtina e shkriu tërë pasurinë që e kishte e ishte i kamur për kohën kur jetoi dhe veprimi për çështje kombëtare. Hasan Prishtina as për së afërmi nuk u vlerësua për kontributin e tij kombëtar, as në Shqipëri e as në Kosovë. Qartazi Hasan Prishtina nuk veprimi për t'u vlerësuar, por se e kishte bindje, qëllim dhe gjakim. Baca Adem Demaçi e kishte shembull veprimtarinë e Hasan Prishtinës dhe e merri si model të një veprimtari kombëtar të përkushtuar, deri në vdekje për liri dhe bashkim kombëtar. Edhe kryeministri i tashëm i Kosovës, së paku deklarativisht e thotë se Hasan Prishtina është shpirti frymëzues i të gjithë shqiptarëve

për liri dhe bashkim kombëtar e që e ka motivuar edhe vetë kryeministrin për veprimtari politike. Nuk e besoj të ketë popull normal në botë e që nuk do të mburrej me personalitetin si ai i Hasan Prishtinës kurse te ne del një rektor i quajtur Qerim Qerimi, i ndikuar nga politika multietnike, me një arsytim gjysmidiotik se pse duhet t'i kthehet emërtimi i mëparshëm i Universitetit të Prishtinës. Në këtë mënyrë po e përzë Hasan Prishtinën, edhe si emërtim por edhe si bust nga oborri i Rektoratit dhe Universitetit për t'ua përmbushur epshin e vëllazërim - bashkimit nostalgjikëve jugosllavë dhe serbë që aktualisht janë fuqizuar shumë duke u metastazuar në të gjitha porët e institucioneve të Kosovës. Edhe 24 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, nuk u gjet as edhe një metër truall në Prishtinë për vendosjen e shtatores së Kryheroit dhe Komandantit Legjendar Adem Jashari, që u sakrifiku, bashkë me familjen dhe me bashkëluftëtarët, pikërisht nga qerimqerimët sikur që po bëhen përpjekje që Frymëzuesi dhe Kuptimi i Luftës së Shqiptarëve për Liri dhe Bashkim Kombëtar, Baca Adem Demaçi të zhvendoset në Podujevë, me qëllim të marginalizimit të figurës së tij, në vend që ta ketë një përmendore monumentale në qendër të Prishtinës. Baca Adem Demaçi, si personalitet i papërsëritshëm nuk e meriton në asnjë mënyrë ta ketë përmendoren as te Sheshi i emërtuar, afër pompës së derivateve të Behgjet Pacollit por pikërisht në qendër. Nëse ish të burgosurit politikë dhe ish bashkëpunëtorët dhe bashkëluftëtarët e Bacës Adem Demaçi do ta lejojnë këtë përmbyseje të trajtimit të një personaliteti siç ishte Baca, atëherë të gjithë ne do të jemi bashkëfajtorë të kësaj përmbyseje morale. Nëse lejohet

që në këtë mënyrë të keq - trajtohet edhe personaliteti i Hasan Prishtinës nga injorantë që përmbushin diktate dhe kërkesa të politikës ditore multietnike, të tillë do të bëhemi edhe ne! Këta që janë pa histori po përplojnë ta rishkruajnë historinë qoftë duke i dërguar çlirimtarët në Hagë, qoftë duke e larguar Hasan Prishtinën nga Universiteti i Prishtinës, qoftë duke penguar ardhjen triumfale të Komandantit Legjendar Adem Jashari në Prishtinë apo duke bërë përpjekje ta marginalizojnë Bacën Adem Demaçi. Mirëpo, të lartpërmendurit, nuk e shkruan historinë por e krijuan historinë, me shumë vuajtje, djersë dhe gjak prandaj, këta të poshtë janë duke e bërë punën e Sizifit për t'i ndryshuar rolet. Të poshtë ishin, të poshtë janë dhe ardhmërinë do ta kenë të poshtë!

Cilat ishin dhe cilat janë propozimet konkurrenente për rimërtim të Universitetit: Nga kotilla e politikbërjes dhe ndikimit politik sot në Kosovë thuhet se ka shumë emra të propozuar, që të gjithë të njohur dhe të shquar për kontributin patriotik gjatë kohës së Rankoviçit, Josip Broz Titos dhe Sllobodan Millosheviçit. Emrat e propozuar janë të Ali Shukrisë, Fahredin Gungës, Rexhai Surroit, Mark Krasniçit, Mehmet Maliqit - Qorrit, Sinan Hasanit, Kolë Shirokës, Rrahman Morinës dhe disa të tjerë. Duket një listë mbresëlënëse, për kotillën në fjalë. Dhe, si kompromis, për t'i ikur emrave të veçantë shkaku se mund të shkaktojë çarje në skenën politike duket se ka mbizotëruar propozimi për emërtim me “Mirë Dita - Dobardan” shkaku se përputhet qind për qind me aktualitetin politik në Kosovë që siguron një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Prandaj iu pengojnë Hasan Prishtina, Adem Demaçi, Adem Jashari, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, Salih Mustafa,

Nasim Haradinaj, Hysni Gucati, heronjtë e gjallë dhe heronjtë e përjetësuar. Prandaj e duan Gjykatën Speciale, prandaj nuk i vizitojnë sepse patriotizmin shqiptar e konsiderojnë si të dalë mode kurse patriotizmin jugosllav dhe serbian e konsiderojnë si melodi të përjetshme për veshët e tyre.

Dje ishin në Bruksel Albin Kurti dhe Besnik Bislimi, me nëntë këshilltarë. Nëse ua analizoni të tashmen dhe të kaluarën e tyre politike dhe kombëtare që e kanë të trashëguar nga paraardhësit e tyre biologjikë, çdo gjë mund të gjeni aty përveç frymës kombëtare. Frymën kombëtare nuk mund ta gjeni aty as si gjurmë apo edhe as si hije. Del të jetë aty patrioti më i madh ai këshilltari kinez i Kurtit, Mao ce Duni që e përcjellë Kurtin gjatë tërë procesit të ngjites në pushtet. Prandaj del një marrëveshje mashtruese për personat e pagjetur me të cilën mashtrohen paturpësisht dhe padrejtësisht familjarët që për më tepër se 24 vite kërkojnë informata për më të dashurit e tyre. Kjo marrëveshje, do ta shohim se nuk bënë asnjë zgjidhje, është thjesht blerje kohe dhe po përdoret për të heshtur reagimet për themelimin e Asociacionit. Serbia, si shtet i organizuar mund edhe t'i hapë dosjet sepse gjithmonë ka mundësi t'i fabrikojë ato. Serbia nuk do ta pranojë asnjë përgjegjësi. Kosova, cilat dosje do t'i hapë; ato të UÇK-së në kohën kur komandant i saj ishte Besnik Bislimi dhe se pati deklaruar se edhe Kosova duhet t'i hapë dosjet e UÇK-së. Injoranti, rrenci dhe mashtruesi, tri në një! Ia kalon edhe vet dr. Xhekilit për ndërrim të pa - fytyrave!

Albin Kurti e ka harruar Hasan Prishtinën dhe Adem Demaçin: Adem Jasharin dhe heronjtë tjerë i përdorë për fushata zgjedhore dhe mbajtje të pushtetit. Deklaron se ka ardhur koha që familja

Jashari të japë një president për Kosovën, e bënë pastaj Vjosa Osmanin. Nuk e di nëse kjo është e familjes Jashari.

Me këto zhvillime e ardhmja e Kosovës nuk po largohet nga Serbia por po lidhet më fort se në kohën e Sllobës, jo me dhunë por me mjete politike. Po jetësohet synimi i ambasadorit Hill për një autonomi substanciale për Kosovën. Po jetësohet dëshira e ambasadorit Hill që sa më shpejt të formohet Asociacioni. Duket se kjo ka qenë e vetmja kërkesë e ambasadorit Hill nga Peshku i Art; formimi i Asociacionit - Zajebnicës. Merreni me mend, draftpropozimi i Asociacionit nga deputetja e Vuçiqit ishte shkruar në alfabetin cirilik. Sikur që Kosova të jetë e Vuk Karaxhiqit. Kryeministri Kurti tha se gjatë këtyre dy viteve plotë 10 herë është takuar me grekun Dendias. Dhe këtë e ka bërë pasi Greqia e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe ka hapur ambasadën në Beograd...Prishtinë. Po kujt leshi ia ndien se sa herë u takua Kurti me Dendias?! Kanë vendosur ta hapin urën mbi lumin Ibër që e ndanë Mitrovicën. Pushteti është i vendosur por janë disa probleme të vogla por të papërballueshme, deklaratat e mashtruesit Lajçak dhe Rrahman Morinës së Katalonjës, Joseph Borrell, deklaratat e KFOR-it dhe atyre që kanë koçë dhe nuk i bartin ato vetëm për nevoja fiziologjike. Do ta shohim, Albini dhe Vuçiqi i kanë shpeshuar takimet. Mendoj se çështje e Asociacionit është punë e përfunduar. Nëse jo, Chollet nuk do ta thërrasë Albinin në telefon e as ndërmjetësuesi me mbiemër frikësues Eskobar nuk do të jetë pjesë e takimeve. Nga praktika dhe përvoja e them se lehtësuesit në këto procese janë rënduesit më të mëdhenj sidomos në fazën merre ose nuk ta japim. Qofsha i gabuar! Uroj që Albini ta ketë të drejtë dhe të dalë e kundërta e kësaj që po e parashikoj!

Përurohët shtatorja e heroit të kombit Fahri Fazliu

OBILIQ, 5 MAJ - Heroi i kombit Fahri Fazliu është rikthyer të premtën i bronzë në qytetin e Obiliqit. Në sheshin që do ta mbajë emrin e tij është zbuluar shtatorja e heroit, në Ditën e Dëshmorëve 5 Majin.

Të pranishëm ishin bashkëlloftëtarë e figura të larta politike në vend e rajon, të cilët nderuan lart jetën dhe veprën e heroit Fahri Fazliu.

Kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka thënë se Fahri Fazliu ishte trim e burrë i fortë dhe mbetet frymëzim për të gjithë. Ai shtoi se heroit qysh i ri në moshën 19-vjeçare u bë pjesë e Lëvizjes Popullore për çlirim të vendit. "Zbulimi i shtatores nuk po ndodh rastësisht sot më 5 maj, sepse kontributi i tij ishte i madh. Së bashku me të tjerët ishim rreshtuar krahi dhe Lëvizjes Popullore.

Fazliu ishte trim e burrë i fortë, dhe mbetet një frymëzim për mua, por edhe për shokët tanë", ka thënë Gashi.

E iniciatori i kësaj shtatoreje, Arben Krasniqi, ka thënë se qytetarët tashmë do ta nderojnë kolosin e tyre. "Nuk është rastësi që sot më 5 maj qytetarët e Obiliqit ta nderojnë kolosin dhe heroin tonë, Fahri Fazliu. Përkushtimi i qytetarëve tanë dhe përkushtimi i nivelit lokal bëri që shtatorja të vendoset sot këtu", ka thënë ai.

Në përvjetorin e kësaj shtatore ishte edhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, i cili tha se qyteti i Obiliqit po pasurohet edhe më shumë me vendosjen e shtatores së Fahri Fazliut. Sipas Ahmetit, me këtë shtatore po nderohet historia e pashlyeshme e shqiptarëve. "Shkëlqimin Fahri Fazliut ia jep



edhe më shumë sepse kjo shtatore po ngritet nga institucionet që dha jetën e gjakun. Andaj nuk i them faleminderit dikujt që punon në shtëpi të tij, por puna e mbarë. Po e pasuron Obiliqin me këtë shtatore", është shprehur Ahmeti. Përfaqësuesi i familjes Jashari, Bekim Jashari, ka thënë se me këtë shtatore nderohen jeta dhe vepra e madhështore e veprimtarit dhe luftëtarit të lirisë, Fahri Fazliut, i cili, sipas tij, që nga protestat e vitit 1981 e deri në rënien e tij heroike, bashkë me heroin Afrim Zhitia, asnjëherë nuk u ndalen duke i

shërbyer kauzës sonë për liri. Kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, Xhavit Jashari, ka thënë se sot me zbulimin e kësaj shtatoreje nderojmë të gjithë heronjtë që në periudha të ndryshme kanë dhënë shumë për lirinë e Kosovës. Në emrin e familjes Fazliu, fjalën e ka marrë i vëllai i Fahriut, Fadil Fazliu, i cili tha se sot është një ditë e veçantë për ta si familje dhe për Obiliqin me rrethinë. Ai falënderoi kryetarin Gashi që mundësoi vendosjen e kësaj shtatore dhe skulptorin Sabri Behramaj i cili e ka

punuar shtatoren. Në pamundësi të marrë pjesë në zbulimin e shtatores së heroit Fahri Fazliu, kryeministri Albin Kurti kishte dërguar telegram urimi. Telegram urimi kishte dërguar edhe bashkëshortja e heroit Agim Ramadani, Shukrije Ramadani. Të pranishëm në zbulimin e shtatores ishin edhe Rifat Jashari, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, përfaqësues të PDK-së, Xhavit Haliti e Bajrush Xhemalli, përfaqësues të FSK-së, Policisë së Kosovës, kryetarë komunash dhe deputetë.

Tahiri diskuton me të rinjtë në Akademinë Politike të FES-it: Vendi ynë është në Evropë

PRISHTINË, 5 MAJ - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka mbajtur një diskutim me liderë të rinj në Akademinë Politike të FES-it. Tahiri gjatë diskutimit ka paraqitur rrugën dhe hapat e Kosovës drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës. Ai ka theksuar se tani është i nevojshëm një plan që të konkretizohet nga të gjithë aktorët institucionalë të vendit, që aspiratat tona të gjejnë rrugë sa më të shpejtë. "Pa asnjë dyshim, brezi i ri është e ardhmja e qëndrueshme. Vendi ynë është në Evropë. Aty e ka vendin!", ka thënë Tahiri.



Fillon faza e dytë e rregullimit të Bulevardit "Ilaz Kodra" në Skenderaj

SKENDERAJ, 5 MAJ - Skenderaj, 5 maj - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka njoftuar se ka filluar faza e dytë e rregullimit të Bulevardit "Ilaz Kodra". Ai ka thënë se kjo hapësirë që ka frekuentim të

lartë do të transformohet me qëllim të modernizimit të shëtitores, instalimit të infrastrukturës së re përcjellëse publike, me trotuar të zgjeruar dhe ndriçim të ri publik.



Nis Festivali Folklorik "Hasi Jehon 2023"

PRIZREN, 5 MAJ - Ka filluar Festivali Folklorik "Hasi Jehon 2023", i cili këtë vit shënon 34-vjetorin, që për tri ditë do të mbahet në

Gjonaj të Hasit. Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Adem Morina, ka bërë hapjen e festivalit tradicional që promovon

vlerat e trashëgimisë kulturore jo vetëm të Hasit, por edhe më gjerë. Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka theksuar se kjo

është prej ngjarjeve kulturore më të vjetra në Kosovë, që do ta gëzojë mbështetjen e komunës vazhdimisht.



Kriza bankare nuk ka mbaruar në ShBA. Sa keq mund të shkojnë gjërat?



WASHINGTON, 5 MAJ - Pasiguria vazhdon ta godasë industrinë bankare pavarësisht prej garancive të dhëna këtë javë nga entet rregullatore financiare apo bankierë të njohur, se më e keqja e krizës së fundit ka përfunduar dhe se shëndeti i sistemit bankar mbetet i fortë. Këtë javë, pas konfiskimit nga qeveria, banka 'First Republic' kaloi në pronësi të bankës 'JPMorgan'. Falimentimi i 'First Republic' ishte falimentimi i dytë më i madh në historinë e ShBA-së dhe i tretë i një huadhënësi të mesëm në dy muaj. Shumë menduan se shitja e bankës 'First Republic' do t'i ndalonte diskutimet se "cila bankë e ka radhën?", investitorët vazhdojnë të përqendrohen tek ata 'lojtarë' të mbetur që konsiderohen më të dobët në sistem. Shqetësimi më i madh është se

falimentimet e bankave mund të çojnë në ngritjen e dyshimeve për banka relativisht të shëndetshme, duke krijuar një 'infektim financiar', që mund të ndikojë më gjerë në ekonomi. Shmangia e këtij skenari ishte arsyeja që në vend u vendosën kufizime më të forta ndaj bankave të mëdha pas krizës financiare të 15 viteve më parë. Aktualisht është e vështirë ta injorosh ndjenjën e shqetësimit që lidhet me bankat. Megjithatë nuk ka nevojë për shqetësim nëse paratë ndodhen në një bankë të siguruar nga Agjencia Federale e Sigurimit të Depozitave dhe nëse keni në bankë më pak se 250 000 dollarë, që mbulon shumicën e llogarive. Bankierët dhe rregullatorët janë përpjekur t'i sigurojnë investitorët se më e keqja e krizës ka kaluar por, pa sukses. Jamie Dimon, bankier i

'JPMorgan', tha të hënën se ai besonte se "kjo pjesë" e krizës bankare kishte marrë fund. Kryetari i Rezervës Federale Jerome Powell garantoj të mërkurën se sistemi financiar është i shëndetshëm. Pas përpjekjeve të reja për shitje, të enjten vëmendja u përqendrua te 'PacWest Bancorp' dhe 'Western Alliance Bancorp', dy banka më të vogla rajonale, aksionet e të cilave kanë qenë nën trysni që pas falimentimit të bankës 'Silicon Valley', në mes të muajit mars, gjë që shkaktoi krizën aktuale. Vlera e bankës 'PacWest' ra 51 % pasi pranoi se po mendonte të dilte në shitje. 'PacWest' ishte në shënjestër për shkak të një përqendrimi të lartë të depozitave të mëdha dhe të pasiguruara nga firmat e kapitalit sipërmarrës ose të fondeve për startup-e si dhe klientë të teknologjisë, të njëjtë

lloj klientësh që nxitën falimentimin e 'Silicon Valley' dhe 'First Republic'. Analistët e bankës së investimeve 'UBS' vlerësojnë se rreth 23 % e depozitave të bankës 'PacWest' vijnë nga firmat e kapitalit sipërmarrës dhe të teknologjisë. Por edhe bankat 'Comerica' dhe 'KeyCorp' kanë rënë me më shumë se 20 % këtë javë. Kjo mund të jetë një pasqyrim i shqetësimeve në rritje për sasi të mëdha kredish për pasuri të paluajtshme, veçanërisht në tregun e pronave për zyra, i cili vazhdon të vuajë efektet e pandemisë. 'PacWest', me qendër në Los Anxhelos dhe 'Western Alliance', në Feniks, lëshuan nga një deklaratë secila brenda natës, duke thënë se nuk po përballeshin me ndonjë tërheqje të depozitave jashtë tërheqjes të zakonshme pas shitjes së bankës 'First Republic'.

Të dyja bankat u përballën me tërheqje të konsiderueshme pas falimentimit të bankës 'Silicon Valley', por bankat thonë se depozitat janë rritur që nga 31 marsi.

'Western Alliance' lëshoi një deklaratë të veçantë të enjten në mëngjes duke mohuar një artikull të gazetës 'The Financial Times' ku thuhet se banka po konsideron mundësinë e shitjes. Aksionet e saj ranë 38 %. Investitorët druhen se fati i bankës 'PacWest' mund të jetë i njëjtë me atë të 'First Republic', e cila kaloi disa javë në kërkim të një blerësi përpara se të falimentonte. 'First Republic' kishte gjithashtu një klientelë të pasur, shumë prej të cilëve tërhoqën me shpejtësi depozitat kur 'Silicon Valley' dështoi. "Çështja themelore, veçanërisht në këto banka, është se përzierja e pronave dhe depozitave të tyre nuk është e qëndrueshme", thotë Chris Caulfield, një konsulent i industrisë bankare që punon për 'West Monroe'.

Si një tjetër sinjal për probleme të mundshme, një marrëveshje e madhe në sektorin bankar u anulua të enjten. 'TD Bank Group' dhe 'First Horizon Corp.' njoftuan se anuluan një bashkim të planifikuar, duke përmendur pengesat rregullatore. Banka 'Toronto-Dominion' njoftoi në shkurt se po blinte bankën rajonale 'First Horizon' falë një marrëveshjeje prej 13.4 miliardë dollarësh në para të thata.

Beteja e Rezervës Federale kundër inflacionit ka luajtur një rol kyç në problemet bankare që po përjeton vendi. Rezerva Federale rriti të mërkurën normën bazë të interesit me një çerek pikë ose 0.25 për qind, në nivelin më të lartë në 16 vjet, rritja e dhjetë radhazi e normës së interesit.

Rritjet e shpeshta të normës së interesit gjatë vitit të kaluar kanë filluar ta ngadalësojnë ekonominë dhe një numër ekonomistësh presin një rënie ekonomike në fund të vitit 2023 ose në fillim të vitit 2024. (Voa)

Zyrtarë të BQK-së dhe të AKK-së takohen për çështje të konkurrencës në sektorin financiar

PRISHTINË, 5 MAJ - Ushtruesi i detyrës i Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Bashkim Nurboja dhe u.d. zëvendësguvernatori për Mbikëqyrje Financiare, Nexhati Kryeziu, kanë pritur në takim kryetaren e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Neime Binaku-Isufi dhe u.d. drejtorin e Përgjithshëm, Selajdin Beqa. Në këtë takim është diskutuar për

bashkëpunimin në mes dy institucioneve me qëllim të koordinimit të politikave bazuar në implementimin e legjislacionit. Guvernatori Bashkim Nurboja me këtë rast ka potencuar se BQK-ja ka për qëllim mbrojtjen e konkurrencës, gjithnjë në frymën e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve dhe shprehu interesimin që bashkëpunimi mes BQK-së dhe AKK-së të avancojë edhe më tutje.

Në këtë takim u.d. guvernatori Nurboja ka kërkuar që Autoriteti i Konkurrencës t'i shikojë rastet, aty ku ka ankesa nga institucionet financiare jobankare për kufizimin e aktivitetit ekonomik që po u shkaktohet nga disa banka. Mbyllja e xhirlogarive në mënyrë të njëanshme të institucioneve financiare jobankare nga ana e disa bankave nuk është praktikë e mirë, e sidomos kur nuk ka arsye të mirë.



Heroi i kombit Fahri Fazliu është rikthyer i bronztë në qytetin e Kastriotit



Nga Astrit GASHI

Të premten në Ditën e Dëshmorëve të kombit 5 Maji u zbulua shtatorja e heroit të kombit Fahri Fazliu në sheshin që do ta mbajë emrin e tij. Të pranishëm ishin bashkëluftëtarë dhe personalitete të larta politike në vend e rajon, të cilët nderuan lartë jetën dhe veprën e heroit, Fahri Fazliu.

Kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka thënë se Fahri Fazliu ishte trim e burrë i fortë, dhe mbetet një frymëzim për të gjitha. Ai shtoi se heroit qysh i ri në moshën 19-vjeçare u bë pjesë e Lëvizjes Popullore për çlirimin e vendit. "Zbulimi i shtatores nuk po ndodh rastësisht sot më 5 maj, sepse kontributi i tij ishte i madh. Së bashku me të tjerët ishim rreshtuar krahi të bashkëluftëtarëve të Lëvizjes Popullore. Fazliu ishte trim e burrë i fortë, dhe mbetet një frymëzim për mua, por

Kosovës, Fahri Fazliu. Nuk ka qenë qëllimi ta zbukurojmë shtatoren me një armë të veçantë si kjo që ai e ka në dorë, por ishte arma, që quhet UZI, ajo që nuk ndahej asnjëherë nga dora e Fahriut. Madje edhe në momentin kur u vra i mbetën duart në pozitën që e kishte armën dhe në atë pozitë edhe është varrosur. Përkushtimi i qytetarëve të



edhe për shokët tanë", ka thënë Gashi.

E iniciatori i kësaj shtatoreje, Arben Krasniqi, ka thënë se "Si inicues i ngritjes së shtatores së heroit Fahri Fazliu, jam shumë i lumtur që sot Fahriu po përjetësohet në bronz në qytetin tonë. Veprimtaria atdhetare e Fahriut shtrihej jo vetëm në kufijtë e sotëm të Kosovës, por në të gjithë hapësirën shqiptare dhe diasporë. Fahriu ka dhënë një kontribut të madh edhe për komunën e Kastriotit. Kjo është edhe arsyeja që sot po ngritët shtatorja e tij afër vendit ku edhe ka punuar. Dhe nuk është rastësi që pikërisht sot, më 5 Maj, në Ditën e Dëshmorëve, qytetarët e kësaj komune po i bëjnë nderim kolosist të veprimtarisë së fshehtë politike patriotike, heroit të

komunës sonë, kuvendit komunal dhe në veçanti përkushtimi i kryetarit Xhafer Gashi bëri që shtatorja e heroit tonë të vendoset



sot këtu", përfundon fjalën e tij veprimtari i çështjes kombëtare, Arben Krasniqi. Në përrurimin e kësaj shtatore ishte edhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, i cili tha se qyteti i Obiliqit po pasurohet edhe më shumë me vendosjen e shtatores së Fahri Fazliut.

jonë në shtepinë e vllëzërvë Sahit e Arben Krasniqit që është iniciatori i kesaj shtatore" është shprehur Ahmeti. Përfaqësuesi i familjes Jashari, Bekim Jashari, ka thënë se me këtë shtatore nderohet jeta dhe vepra e madhështore e veprimtarit dhe

ndryshme kanë dhënë shumë për lirinë e Kosovës.

Edhe Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në përrurimin e shtatores së heroit të kombit, Fahri Fazliut. "Fahri Fazliu i takon brezit të hershëm të lëvizjes për liri, brezit të luftëtarëve të cilët ranë me armë në dorë për çlirimin e Kosovës. Pikërisht në Ditën e Dëshmorëve, ai po përjetësohet në bronz, në qendër të Kastriotit. Kontributi i tij jetësor në shërbim të lirisë së Atdheut do të nderohet ndër breza!", ka thanë Haradinaj.

Në emrin e familjes Fazliu, fjalën e ka marrë i vëllai i Fahriut, Fadil Fazliu, i cili tha se sot është një ditë e veçantë për ta si familje dhe për Obiliqin me rrethinë. Ai falënderoi kryetarin Gashi që mundësoi vendosjen e kësaj shtatore dhe skulptorin Sabri Behramaj, i cili e ka punuar shtatoren.



Në pamundësi të marrë pjesë në zbulimin e shtatores së heroit Fahri Fazliut, kryeministri Albin Kurti kishte dërguar telegram urimi. Telegram urimi kishte dërguar edhe bashkëshortja e heroit Agim Ramdani, Shukrije Ramadani. I pranishëm në zbulimin e shtatores ishte edhe Rifat Jashari, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, përfaqësues të PDK-së, Xhavit Haliti e Bajrush Xhemali, përfaqësues të FSK-së, Policisë së Kosovës, kryetarë komunash dhe deputetë.



Sipas Ahmetit, me këtë shtatore, po nderohet historia e pashlyeshme e shqiptarëve. "Shkëlqimin e Fahri Fazliut i jep dhe me shumë sepse kjo shtatore po ngritët nga institucionet që dha jetën e gjakun. Andaj nuk i them faleminderit dikujt që punon në shtëpi të tij por puna e mbarë. Po e pasuron Kastriotin me këtë shtatore. Jo larg nga ketu ishte selia

luftëtarit të lirisë, Fahri Fazliut, i cili sipas tij, që nga protestat e vitit 1981 e deri në rënien e tij heroike bashkë me heroin Afrim Zhitia asnjëherë nuk u ndalen duke e shërbyer kauzës sonë për liri. Kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, Xhavit Jashari, ka thënë se sot me zbulimin e kësaj shtatore nderojmë të gjithë heronjtë që në periudha të





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

FFK-ja licencohet nga MKRS-ja

“Epoka e re”

PRISHTINË, 5 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës e ka përmbyllur procesin e licencimit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sipas udhëzimit të ri administrativ për licencimin e federatave. Ministri i Sportit, Hajrulla Çeku, të premten ka nënshkruar vendimin për licencimin e FFK-së, bazuar në rekomandimin e Komisionit për Licencimin e Federatave

Sportive (KVLFS). Ashtu sikurse edhe federatat tjera sportive të cilat ishin të përfshira në këtë proces, edhe FFK-ja pas plotësimit të të gjitha kriterëve dhe kushteve të kërkuara, është licencuar për ciklin aktual olimpik. “Duke pasur parasysh se FFK-ja është organizata më e madhe sportive në vend dhe me numrin më të madh të klubeve, ky proces ka marrë kohë të konsiderueshme deri te përmbyllja e licencimit. Por pas një angazhimi të madh të administratës së FFK-së,

klubeve dhe ministrisë është arritur të plotësohen kushtet për licencim”, thuhet në njoftimin e FFK-së. Federata e Futbollit e ka përgëzuar zyrën e sekretarit me administratën, si dhe të gjitha klubet që kanë punuar me përkushtim në këtë proces të ngarkuar dhe me kushte specifike. Përmbyllja e këtij procesi tregon se FFK-ja është duke punuar drejt standardit më të lartë të menaxhimit dhe transparencës si në federatë, ashtu edhe në klube.



Ekipi olimpik i xhudos synon medalje botërore

PRISHTINË, 5 MAJ - Ekipi olimpik i xhudos së Kosovës, do të garojë në Kampionatin Botëror, që prej 7 deri më 14 maj 2023 mbahet në Doha të Katarit. Shtatë garues do të synojnë të fitojnë medalje në garën kryesore të vitit, e njëkohësisht edhe pikë të reja olimpike për Lojërat Olimpikë “Paris 2024”. Ekipi përbëhet nga kampionia olimpikë,

Distria Krasniqi, që në bagazhin e saj ka edhe dy medalje të bronzta të botës, kampionia olimpikë, Nora Gjakova, medaliste e bronzit e botës, Lorian Kuka, po ashtu medaliste e bronzit e botës, si dhe Akil Gjakova, Laura Fazliu, Flaka Loxha dhe Erza Muminoviq. Ky ekip do të udhëhiqet nga trajneri Driton Kuka dhe asistentja e tij,

Majlinda Kelmendi, që si garuese është dy herë kampione e botës dhe një herë medaliste e bronzit. Të hënën garojnë Krasniqi e Muminoviq në kategorinë -52 kg, të martën Nora Gjakova e Flaka Loxha (-57 kg), si dhe Akil Gjakova (-73 kg), të mërkurën garon Fazliu (-57 kg), ndërsa të premten Kuka (-78 kg).

Ndeshje të forta për vend në finale të Kupës

PRISHTINË, 5 MAJ - Në pjesëmarrjen e parë në turneun final të Kupës së Kosovës në hendboll, Rahoveci shpreson të bëjë befasi të madhe. Përballë Rahovecit në gjysmëfinale do të jetë fituesja në fuqi e Kupës së Kosovës, Besa Famgas. Besa llogaritet favorite, por “vreshtarët” kanë premtuar maksimumin. Ndeshja Rahoveci-Besa Famgas zhvillohet të shtunën prej orës 15:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Ndërkohë në gjysmëfinalen e dytë është vështirë të favorizohet ndonjëra skuadër. Prej orës 19:00 takohen Trepça

e Prishtina. Dy skuadrat me traditë kanë luajtur ndeshje të forta gjatë gjithë edicionit. Trepça në plejof starton prej pozitës së dytë e Prishtina prej të tretës. Këto skuadra takohen edhe në gjysmëfinale të plejofit. Por fillimisht gjithë fokusin e kanë te gjysmëfinalja e Kupës së Kosovës. Si Trepça ashtu edhe Prishtina e kërkojnë vendin në finalen e të dielës. Dy ndeshjet pritet të jenë cilësore, me aksione të rrjedhshme e gola të bukur. Me numër më të madh të shikuesve në palestër, spektakli hendbollistik do të jetë edhe më i madh.



Dënohen Trepça dhe Peja

MITROVICË, 5 MAJ - Dy skuadrat Trepça e Peja janë gjobitur pas ndeshjes së parë finale të plejofit në Superligën e Kosovës në basketboll. Trepça, që ishte vendase të mërkurën, është gjobitur me 750 euro gjithsej. Ndërkohë Peja është

gjobitur me 200 euro, sa edhe lojtari i saj, Alban Veseli. Trajneri Rami Hadar është gjobitur me 50 euro. Vendimet i mori të premten Komisioni i Garave i FBK-së. Veseli dhe Hadar u ndëshkuan me gabime teknike, ndërsa për

shikuesit në vendim thuhet se kanë hedhur gjësende të buta, kanë ofenduar skuadrën mysafire dhe kanë ndezur mjete piroteknike. Trepça e ka fituar ndeshjen e parë finale. Ndeshja e dytë është të dielën në Pejë.



Blend Baftiu, 'Ylli i javës' në Superligë

Prishtinë, 5 maj - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall vazhdojnë ndarjen e çmimit "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 32-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Drita, Blend Baftiu. Komisioni vlerësoi se Baftiu ishte lojtari më i spikatur në fitoren tejte të rëndësishme

që Drita e realizoi kundër Llapit në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë (2:0). Përveç golit të realizuar, Blendi pati paraqitje shumë të mirë gjatë gjithë ndeshjes. Çmimin "Jam shumë i lumtur për çmimin, i cili do të jetë motiv shtesë për ndeshjet e fundit të këtij edicioni. Për këtë i falënderoj bashkëlojtarët, pa të

cilët kjo nuk do të ishte e mundur, por në veçanti jam i lumtur për fitoren e arritur dje kundër Llapit. Një fitore shumë e rëndësishme për vazhdimësinë drejt qëllimit tonë, e që është titulli kampion. I falënderoj edhe tifozët tanë 'Intelektualët' për mbështetjen e vazhdueshme që na kanë dhënë

gjatë gjithë vitit, e sidomos në takimin e djeshëm. Shpresoj dhe besoj se edhe të dielën kundër Ballkanit, që ndoshta është edhe ndeshja më e rëndësishme e kampionatit, të jemi triumfues. Drita FC si me organizim, ashtu edhe me fondin e futbollistëve është skuadër që e meriton titullin e



kampionit në këtë edicion", ka theksuar Baftiu.

Të dielën zhvillohet finalja e dytë mes Pejës dhe Trepçës

PEJË, 5 MAJ - E diela është e rezervuar për serinë e dytë të finales së "play-off"-it në basketboll mes Pejës e Trepçës. Në këtë duel, mitrovicasit hyjnë me epërsi prej 1:0 nga ndeshja e parë e zhvilluar të enjten mbrëma në palestrenë "Minatori". "Xehetarët" kishin triumfuar me tetë pikë epërsi, në një sfidë ku fituesi u përcaktua në çerekun e katërt, aty ku gjelbër e zinjët i ndezën turbinat dhe triumfuan në fund 94:86. Tre basketbollistë ishin më të dalluarit për fitoren e Trepçës, derisa më i miri ishte Jamal Artis me 27 pikë. E për pejanët nuk mjaftuan 23 pikët e Larry Thomas. Ndeshja e së dielës do të jetë një tjetër episod interesant, aty ku Peja për dallim në Mitrovicë, këtu do ta ketë mbështetjen e tifozërisë së vet. Deri në këtë fazë, pejanët kishin arritur pasi në çerekfinale kishin pushuar, pasi kishin përfunduar të dytë në tabelë, derisa në gjysmëfinale e kishin mposhtur Yllin lehtësisht 3:1 në seri. E në krahun tjetër, Trepça e



cila e mbylli edicionin e rregullt në vendin e katërt, në çerekfinale eliminoi Bashkimin, derisa në gjysmëfinale Sigal Prishtinën, 3:2 në seri. Ekipi i cili në këtë fazë arrin tri fitore shpallet kampion i këtij edicioni. E sa jemi tek

kampioni, këtë epitet nga sezoni i kaluar e mbanë Ylli, që e kishte mposhtur Trepçën 3:1 në seri. Sa jemi tek Trepça, ata këtë edicion kanë fituar Kupën e Kosovës, ku në finale triumfonin ndaj Bashkimit.

Golden State barazon serinë gjysmëfinale ndaj Lakersave

SAN FRANCISCO, 5 MAJ - Ekipi kampion i Golden State fitoi me rezultat 127-100 ndaj Lakersave në ndeshjen e dytë gjysmëfinale "play-off", duke barazuar 1-1 serinë e takimeve mes dy



Edhe stoli vendimtar për Warriors, nga ku erdhën 40 pikë. Te Lakersat u dallua James me 23 pikë e Hachimura me 21, ndërkohë që

nuk dha atë që pritej Davis. Gjithsesi, dy sfidat e radhës do të luhen në fushën e Lakersave, që synon të dalë sërish përpara.

KONFERENCA E LINDJES, "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE

Boston - Philadelphia (1-1)
New York - Miami (1-1)

KONFERENCA E PERËNDIMIT, "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE

Denver - Phoenix (2-0)
Golden State - Lakers 127-100 (1-1)

skuadrave që luajnë në Konferencën e Perëndimit. Një ndeshje e dominuar nga vendasit, ku të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë. Klay Thompson me 30 pikë ishte shënuesi më i mirë, mbështetur nga Stephen Curry me 20 pikë.

Bayerni në bisedime me Kolo-Muanin

Pas publikimit të lajmit, se "bavarezët" e Bayern Munich janë në kërkim të një sulmuesi, i cili mund të jetë një nga dyshja Randal Kolo-Muani ose Rasmus Hojlund, "bavarezët"

kanë vendosur të nisin gjithçka që sot, teksa kanë hapur bisedimet me rivalët e Eintracht Frankfurt për të siguruar shërbimet e francezit. Kolo-Muani e dëshiron një

transferim te një klub i nivelit të "bavarezëve", mirëpo problem do është shifra e madhe që bordi i "shqiponjave" kërkon për 24-vjeçarin francez, me këta të fundit që duan plot 120

milione euro, ndërsa "bavarezët" janë të gatshëm të japin vetëm gjysmat. Pavarësisht dallimeve në vlerësimin e lojtarit, pritet që palët të arrijnë një marrëveshje,

mirëpo problemi për Bayern është interesimi i Manchester United dhe PSG, të cilët janë të gatshëm të hapin "thesin", për një lojtar të nivelit të Kolo-Muani.

SHKURT

Nadali tërhiqet edhe nga 'Italian Open'

Rafael Nadal ka njoftuar se nuk do marr pjesë në Italian Open në javën e ardhshme, shkak lëndimi. Nadal nuk ka konkurruar në një ngjarje sportive që nga "Australian Open" në janar. 36-vjeçari spanjoll nuk është rikuperuar nga problemet e muskujve të kofshës që e kanë shqetësuar. Megjithatë, ka një shpresë për të që të luajë në Roland Garros. "Megjithëse kam vënë re disa përmirësime ditë e fundit, nuk jam stërvitur në nivel të lartë për disa muaj dhe procesi i ripërshtatjes kërkon kohën e vet. Kështu që unë vetëm duhet ta pranoj këtë dhe të vazhdoj të punoj", ka thënë Nadal.

Vdes ish-trajneri i Realit

Ish-trajneri i Real Madridit dhe Deportivo La Corunas, Arsenio Iglesias ka ndërruar jetë në moshën 92 vjeçare. Trajneri i njohur dhe legjendar morri drejtimin e shumë klubeve spanjolle gjatë karrierës së tij, e cila zgjati 41 vite nga 1967 deri në vitin 2008. Iglesias njihet më shumë për kohën e tij te Deportivo La Coruna, ku ai kaloi katër sezona dhe e fitoi Kupën e Mbretit në vitin 1995. Gjatë kohës kur ishte lojtar, Iglesias u paraqit për klube të njohura spanjolle si Deportivo, Sevilla dhe Granada, para se të pensionohej në vitin 1966. Ai e filloi karrierën si trajner në vitin 1967, duke marrë drejtimin e skuadrës B të Deportivo La Corunas, Deportivo Fabril.

Messi kërkon falje

Paris Saint-Germain pezulloi Lionel Messin nga skuadra për dy javët e ardhshme, për shkak se superylli argjentinas nuk i ishte bindur urdhrave të klubit. Messi udhëtoi drejt Arabisë Saudite për të kaluar kohë me familjen e tij, por që ky udhëtim nuk ishte i autorizuar nga PSG-ja. Pavarësisht se kishte marrë një "JO" nga PSG, Messi vazhdoi me udhëtimin të cilin e kishte organizuar për një kohë të gjatë, gjë kjo e cila e detyroi kampionin francez ta dënojë atë. Tani, Messi ka reaguar për herë të parë që prej se PSG e pezulloi atë. "Unë mendova se ne do të kishim një ditë pushim pas ndeshjes si çdo herë. E kam pasur këtë udhëtim të organizuar dhe unë nuk mund ta anulova atë. Veçse e kisha anuluar më herët", ka thënë Messi. "Unë u kërkoj falje shokëve të mi të skuadrës dhe unë jam duke pritur për atë se çfarë klubi dëshiron të bëjë me mua", ka shtuar Messi.

Juve, afër marrëveshjes me Torresin

Juventus është afër një marrëveshjeje për të nënshkruar me mbrojtësin e Villarrealit, Pau Torres, raporton gazeta spanjolle "Sport". Kontrata e qendërmbrojtësit spanjoll skadon në vitin 2024 dhe nuk ka ndërmend të rinovojë marrëveshjen me klubin. Tashmë ka pasur dy takime mes drejtuesve të "Zonjës së Vjetër" dhe agjentëve të futbollistit, të cilat kanë nxjerrë përfundim pozitiv të negociatave. Klauzola e lirimit është 50 milionë euro, por mund të arrihet akord për një shifër më të ulët. Juventus tashmë po pret për ofertën finale kundrejt Villarreal për shërbimet e Pau Torres, për të kuptuar nëse klubi spanjoll do të marrë pjesë në kompeticione europiane sezonin e ardhshëm.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Artan Gugushka shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Blerta Rexhaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - V shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- "True Choice" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit ,e nr 810171215 si dhe certifikatën e TVSH-së, 330492512.

- Ajmane Shala shpall te pavlefshme diplomën e "Kolegjit Fama".

- Elheme Sinani shpall te pavlefshme 4 dëftesat e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

- HALIME ISLAMI, shpall të pavlefshme dëftesat e vitit te pare dhe te dyte te shkollës se mesme "HASAN PRISHTINA".

- BAHRIJE MUSA, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1 deri 8 të shkollës fillore "OSMAN RAMA".

- GEZIM RRUSTEMI, shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme "XHELADIN DEDA".

- Leotrim Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 10-të të lëshuar nga SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Drejton Gjoshi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl I,II,III,të sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Ligj Buqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Fidan Sokoli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Muhamet Ahmeti, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- Sabri Abazi, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme QSHT "Boris Kidric", Shkolla e re "Arkitekt Sinani".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

